



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Deliverty	20	10	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKUMSHOK	6355/2022		115		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.776/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesat me numër A.nr.736/2022 të datës 25.08.2022 si dhe A.nr.776/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruara nga ankuesi me adresë në Komunën e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 20.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.736/2022 e datës 25.08.2022 si dhe ankesa me numër A.nr.776/2022 e datës 07.09.2022 të parashtruara nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi KA.nr.28/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe lënda kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. **Detyrohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh, të ndërmar veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë në pozitën "Administrator" sipas Akt emërimit me numër Nr.03/167 të datës 07.04.2014, i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me datën 29.07.2022, ankuesit i është lëshuar kontrata e punës për kohë të pacaktuar me numër Nr.01/1094 nga ana e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në pozitën si "Administrator" pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë me mandat prej pesë (5) vitesh duke filluar nga 29.07.2022-28.07.2027, bazuar ne Ligjin e punës si dhe ne Vendimin KGJK nr.255/2022 te datës 31.05.2022 për miratimin e Rregullores Nr.04/2022 lidhur me procedurën e rekrutimit ,përzgjedhjes dhe themelimin e marrëdhënies së punës për administratorët e gjykatave.

I pakënaqur me zëvendësimin e akt emërimit në kontratë të punës nga ana e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 10.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër Nr.01/1521 tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së. Kjo e fundit me datën me datën 29.08.2022 ka nxjerrë Vendimin KA.Nr.28/2022 sipas së cilit e ka shpallur veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Ankuesi fillimisht me datën 25.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4974/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me zëvendësimin e akt emërimit në kontratë të punës nga ana e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe me datën 07.09.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5199/2022 në Këshill kundër Vendimit KA.nr28/2022 të datës 29.08.2022 i nxjerrë nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së lidhur me ndërrimin e statusit të nga shërbyes civil në zyrtar me kohë të pacaktuar dhe zëvendësimit të akt emërimit në kontratë pune me kohë të caktuar.

Me datën 06.10.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.109/2022 sipas të cilit i është zgjatur afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune për shkak të specifikave të lëndës, ndërsa bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave të datës 12.10.2022 lidhur me bashkimin e ankesave A.nr.736/2022 te datës 25.08.2022 si dhe A.nr.776/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruara nga ankuesi Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 12.10.2022 ka nxjerrë Vendimin VK.Nr.115/2022 sipas të cilit i ka bashkuar ankesat e ankuesit sipas ankesës së fundit me numër A.nr.776/2022, pasi që baza ligjore dhe objekti i shqyrtimit janë të njëjta.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datën 12.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 23.09.2022, ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vendosjes meritore në lidhje me këtë ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4974/2022 të datës 25.08.2022 si dhe ankesën me numër të protokollit 5199/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruara nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e marrëdhënies së punës të ankuesit të datës 06.06.2007; Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.03/167 të datës 02.04.2014; Kontratën e punës për kohë të caktuar të ankuesit me numër Nr.01/1094 të datës 29.07.2022; Rregulloren NR.04/2022 për procedurën e rekrutimit, përzgjedhjes dhe themelimit të marrëdhënies së punës për administratorë të gjykatave të datës 31.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.09.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkresat e bashkangjitura në lëndë; Vendimin me numër KA.nr.28/2022 të datës 29.08.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK; Ankesën e ankuesit me numër Nr.01/1571 të datës 10.08.2022 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK; Vendimin VK.nr.109/2022 të datës 06.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë të datës 12.09.2022 nga Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin VK.nr.115/2022 të datës 12.10.2022 nga Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar janë përmbushur kushtet ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në rivendosje, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit KA.nr.28/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të ankuesit me numër Nr.01/1094 e datës 29.07.2022 e lëshuar nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, konstatoj se për nëpunësit civil të Këshillit Gjyqësor të Kosovës aplikohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili në paragrafin 6 të nenit 3 ka përcaktuar se: *"6. Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se mbështetur në nenin 29 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, është përcaktuar se: *"Administratori i gjykatës zgjidhet dhe shkarkohet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, në një proces të hapur dhe konkurrues, pas shpalljes publike të pozitës"*, ndërsa neni 38 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka përcaktuar se: *"Këshilli në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil realizon procedurat e rekrutimit dhe të mbikëqyrjes së Administratorëve të gjykatave"*, po ashtu me paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *"Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit përcaktohen me Ligjin për Gjykatat dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli"*.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se meqenëse për nëpunësit e shërbimit civil të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, aplikohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë sipas këtij ligji, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka qenë kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit, rrjedhimisht për rastin konkret të ankuesit ky komision ka dështuar të shqyrtoj në mënyrë të drejtë bazën ligjore ,gjendjen faktike dhe ka vendosur në kundërshtim me kompetencat e tij të përcaktuara sikurse në nenin 80, 81 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, nenin 82 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Vendimi KA.nr.28/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shihet se është edhe kontradiktor në përmbajtje për faktin se në arsyetim të të njëjtit konstatohet se nuk është kompetentë për të vendosur në lidhje me ankesën e ankuesit nga se i njëjti nuk e ka statusin e nëpunësit civil dhe po ashtu të njëjtin përmes këshillës juridike sa i përket mjetit juridik e udhëzon direkt për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, institucion ky që vendosë me rastin e parashtrimit të ankesave për Nëpunësit Civil. Kolegji i këshillit ndërlidhur me situatën e ankuesit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në një formë përmes kësaj këshille juridike përveç fakteve tjera të potencuara si më lartë e konfirmon edhe vetë se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil, andaj mbi këto baza ligjore i njëjti nuk ka vendosë në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje përkatësisht nuk e ka trajtuar meritorisht ankesën e ankuesit sipas legjislacionit në fuqi të shërbimit Civil përkatësisht Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili aplikohet për këtë institucion, realisht Vendimi KA.nr.28/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh

nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.776/2022, datë 24/10/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore Gashi-Bajraktari



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.